



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
-Shërbimi i kuvendit-

01Nr.60/01-27447 /19
Kaçanik, 10.09.2019

PROCESVERBAL

Dëgjimi publik i organizuar nga Kryesuesi i Kuvendit në bashkëpunim me Komitetin për Politikë dhe Financa, Komitetin për Shërbime Publike dhe Komitetin për Komunitete, me Administratorët e fshatrave dhe me përfaqësuesit e OJQ e Komunës së Kaçanikut, lidhur me buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2020 dhe vlerësimet për vitet 2021-2022. Takimi është mbajtur me datë 10.09.2019 (e Martë) me fillim pune në ora 11:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Në takim ishin të pranishëm : Kryesuesi i Kuvendit, z. Kemajl Mërseli, anëtarët e KPF-së: Nexhat Loku, Pranvera Loku-Zharku, Selim Reka, Ekrem Kyçyku, Hafize Sallahu, kryesuesja e Komitetit për Komunitete znj. Lirije Luta. Nga ekzekutivi i komunës morën pjesë : Kryetari i Komunës z. Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës, z. Ylber Bajra, Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, z. Bahri Selimi, Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencia, z. Ramadush Osmani, Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, z. Ukshin Çallaku dhe Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Fatmir Loku.

Në takim morën pjesë Administratorët e fshatrave dhe Përfaqësuesit e Organizatave Joqeveritare. (Të bashkangjitur keni edhe listën e pjesëmarrësve në takim).

Kryesuesi i Kuvendit, z. Kemajl Mërseli, Ju përshëndes dhe ju falënderoj për pjesëmarrje në këtë debat publik lidhur me buxhetin e komunës për vitet 2020-2022.

Së bashku me KPF jemi të obliguar të organizojmë debat publik lidhur me buxhetin e komunës. Besoj që secili nga pjesëmarrësit në takim do të jepni kontributin tuaj.

Drejtori i DEFZH, z. Bahri Selimi, Përshëndetje për të gjithë. Buxhetin e komunës ,ne si drejtori jemi të obliguar para datës 1 shtator ta përcjellim në Kuvendin e Komunës, dhe ashtu kemi vepruar. Vlera e buxhetit për vitin 2020 është 9,000,530.00€. Në rritjen e buxhetit ka ndikuar edhe Ligji për pagat, mirëpo ka ngritje edhe te investimet kapitale. Jemi të gatshëm dhe mirëpresim kërkesat dhe sugjerimet tuaja.

Kryetari i Komunës, z. Besim Ilazi, Përshëndetje për të gjithë. Drejtori i DEFZH-s i elaboroj në pika të shkurta disa nga pikat e buxhetit të komunës. Kemi bërë një orientim të buxhetit , nëse kemi mundësi edhe mund të ndryshojmë diçka ,varësisht nga kërkesat nëse ja vlejnë të ndryshohet. Para jush keni listën e investimeve kapitale, presim sugjerimet dhe kërkesat tuaja.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Kemajl Mërseli, Ne sot diskutojmë për investimet kapitale dhe subvencionet dhe transferet , pasi që në takim janë të ftuar administratorët e fshatrave dhe OJQ. Hapim diskutimin.

z. Fadil Vishi, Fillimisht e kam verifikuar buxhetin e komunës dhe listën e investimeve kapitale dhe vërejta që f. Dubravë nuk është përfshirë në listën e investimeve kapitale. Kam disa kërkesa për f. Dubravë: Kemi problem me ujë të pijes, me rrjedhjen e ujërave të zeza nga lagjja Vishaj në lagjen Kamish, rregullimin e shtratit të përroit, përmirësimi i rrugës që del te varrezat e dëshmorëve. Në disa shkolla janë bërë salla të Edukatës Fizike, ndërsa në shkollën e f. Dubravë nuk është paraparë.

z. Naser Mërseli, Kërkesë urgjente në f. Doganaj është ndërtimi i trotuarit nga f. Doganaj deri te udhëkryqi dhe ndriçim publik.

z. Remzi Reka, OJQ "Gjethi", Gjendja në komunën tonë është e padurueshme në të gjitha fushat. Të ndërtohen kolektorë nga f. Kaçanik i Vjetër. Problem tjetër janë hapësirat gjelbëruese, nuk kemi hapësira gjelbëruese de ato që janë nuk mirëmbahen. Ka lagje dhe fshatra që nuk kanë ujë të pijes. Kërkesë tjetër është edhe projektimi i impiantit, edhe pse është i kushtueshëm por duhet të kemi projekt. Kërkesë tjetër është shtaza për biçiklete rreth lumit Lepenc deri në komunën e Hanit të Elezit.

Kryetari i Komunës, z. Besim Ilazi, Sa i përket kërkesave të z. Fadil Vishit, 1,944,139.00€, të buxhetit të komunës parashihen për investime kapitale. Duhet të kemi një kërkesë të arsyeshme që të heqim një projekt tjetër nga kjo listë e investimeve kapitale. Sa i përket kërkesës së z. Naser Murseli për ndërtimin e trotuarit e kemi parasysh , mirëpo për këtë vit nuk ka mundësi të realizohet. Sa i përket kërkesës së z. Remzi Rekës, rreth ndotjes së lumit Nerodime, ndotësi më i madh i lumit është komuna e Ferizajt. Uji i pijes është shqetësim për të gjithë, mirëpo nuk ka sasi të mjaftueshme të ujit. Projektin e impianteve nuk kemi mundësi ta bëjmë për shkak të kostos së lart. Staza për biçikleta rreth lumit Lepenc deri në Hanë të Elezit, është një ide e mirë, do ta kemi parasysh.

Drejtori i DSHPE-s, z. Ramadush Osmani, Këtë vit i kemi të ndara 10,000.00€ për hapësirat gjelbëruese. Këto që i kemi po mundohemi t'i mirëmbajmë. Çdo vit mundohemi të evidentojmë ndonjë pjesë për hapësira gjelbëruese.

z. Remzi Reka, OJQ "Gjethi", Ne na pengojnë disa projekte të paplanifikuara mirë. Kur të bëhet projekti për një rrugë të planifikohet mirë nga fillimi.

z. Ekrem Kycyku, Flas në emër të SHBA "Kaçaniku 2015". Shuma për subvencione është e vogël. Vitin e kaluar kemi marrë një shumë modeste nga Komuna, për disa aktivitete të shoqatës dhe për gjithë aktivitetin që kemi bërë dhe shpenzimet e bëra , kemi sjellë raport në Kuvendin e Komunës. Kërkoj që të subvencionohen shoqatat dhe klubet që kanë sukses.

Kryetari i Komunës, z. Besim Ilazi, Ne kemi bërë kërkesë për rritje të subvencioneve dhe transfereve , mirëpo nuk është futur kjo kategori nga niveli qendror. Me përjashtim të K.F. Lepenci, të tjerat kanë vetëm një shumë simbolike.

z.Qendrim Vogliqi, Kërkesë për DSHPE, Ndërtimi i impiantit për ujëra të zeza parashihet në listën e investimeve kapitale.
Kërkesë për asfaltimin e rrugës “Jashar Vogliqi”.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Kemajl Mërseli, Është koduar ndërtimi i impiantit për arsye të tërheqjes së ndonjë donacioni.

z.Selim Reka, Të gjitha kërkesat tuaja do të kenë përkrahjen tonë në Kuvend. Sa i përket buxhetit është shumë e vogël në krahasim me kërkesat, mirëpo ne duhet të shohim diçka më me prioritet dhe me prioritet duhet të jetë uji i pijes. Duhet të gjejmë alternativa për ujë të pijes. Kërkojë që mjetet të pika 22 të lista e investimeve kapitale, që janë paraparë për ndriçim publik, të barten këto mjetet për rregullimin e ujësjellësit. Të bëhet pagesa e transportit të nxënësve të disa fshatrave, siç janë; Strazhë, Gllaboçicë etj.

z.Elmaz Hasaj, Të bëhet rreth rrotullim në f.Gabrricë, në rrugën që lidhe f.Gabrricë dhe f.Bajnicë, si dhe të bëhet zgjerimi i kësaj rruge. Gjithashtu kërkojmë ndriçim publik në f.Gabrricë.

z.Shkodran Elezi, Nuk ka projekte për f.Sllatinë. Asfaltimi i rrugës ka ndikuar në shtimin e numrit të turistëve. Gjithashtu kërkojmë edhe ndriçim publik.

Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, Asfaltimi i rrugës është bërë deri te shtëpia e fundit e fshatit. Do të asfaltohet çdo rrugë që nuk është asfaltuar në komunën tonë.

z.Kjani Sallahu, Si administrator i f.Biçec, kërkojë rritjen e buxhetit për rregullimin e infrastrukturës së f.Biçec, nga 40,000.00€ në 60,000.00€. Ndriçimin publik në f.Biçec. Shtretërit e përroskave në f.Biçec. Rehabilitimin e ujësjellësit në f.Biçec. Kanalin e ujitjes së tokave në pjesën nën autostradë. Trajtimin e gropës septike të “Mulliri i Katunit” në f.Biçec. Ngritjen e një monumenti historik të UÇK-së në lagjen Zharku në f.Biçec. Çka është paraparë për turizmin në f.Biçec.

Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, Merrni vitin 2020 si projeksion, shumat mund të shtohen. Ndriçimin publik vetëm e kemi koduar. Sa i përket turizmit e kemi paraparë një shumë simbolike, nëse mund të marrim ndonjë donacion. Sa i përket ujësjellësit në f.Biçec CDU ka dashur të marrë nën menaxhim ujësjellësin mirëpo është refuzuar nga komuniteti.

Drejtori i DSHPE-s, z.Ramadush Osmani, Sa i përket ndriçimit publik, disa lagje vet kanë shprehur gatishmëri të bëjnë ndriçimin publik, ndërsa ne ti paguajmë shpenzimet e energjisë elektrike. Sa i përket ujësjellësit, Bifurkacioni mirëmban ujësjellësin, besojmë që do të kalojë në nivel qendror. Sa i përket kanalizimeve ne i kryejmë kolektorët kryesor. Aty ku mund t'i kryej komuniteti, ne i japim gypin.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Kemajl Mërseli, Sa i përket ndriçimit publik, komuniteti i f.Doganaj dhe f.Soponicë e kanë kryer vet, ndërsa shpenzimet e energjisë elektrike i paguan komuna. Të stimulohen nga komuna komunitetet për ndriçim publik.

Ardiana Tusha, në kuadër të KVRL-së, kërkoj të dimë çka po ndodh me sallën e sporteve, kur përfundojnë punimet? Në këtë listë të investimeve kapitale nuk figuron qendra rinore, dimë që janë duke u bërë investime.

Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, Projektet që menaxhohen nga Ministrinë në nuk kemi përgjigje.

z.Aziz Koxha, i përfaqësues i KF. Lepenci, kërkoj të di se çka parashihet në pikën 50 , rregullimi i stadiumit "Besnik Begunca", në vlerë 15,000.00€.

Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, Ka filluar tenderimi , projekti ka vlerën 5.7 milion euro. Faza e parë kushton 970,000.00€.

z.Aziz Koxha, 47,000.00€ për sport janë pak. KF. Lepenci për përfundim sezone i shkojnë 25,000.00€. Sportit në komunën e Kaçanikut i duhet 100,000.00€.

znj.Elmi Hane Malsiu, Kemi hartuar një plan veprimi për Persona me Aftësi të Kufizuara, është formuar edhe Komiteti konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara. A keni paraparë mjete për Persona me Aftësi të Kufizuara?

Drejtori i DEFZH, z.Bahri Selimi, 206,540.00€ është vlera e të gjitha subvencioneve dhe transfereve të parapara për vitin 2020. Për HANDIKOS kemi nda 3,500.00€, nuk mund të ndajmë shuma të mëdha.

z.Hasip Salihu, Kërkesë nga f.Bajnicë është shtimi i kapacitetit të ujit. Ne kemi pranuar ndihmën e CDU-s, mirëpo nuk e dimë pse ka ngecje.

Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, Do të dalin zyrtarët në teren në f.Bajnicë dhe të shohim deri ku kanë arritur punët.

z.Zymer Luma, problem kryesorë në f.Gllloboçicë e kemi çështjen e ujit të pijes.

z.Avni Gabrrica, Prioritet i f.Koxhaj është rregullimi i trotuarit dhe çështja e varrezave, nuk kemi hapësirë.

z.Fadil Vishi, Kemi pasur marrëveshje me kompaninë Bechtel Enka rehabilitimin e rrugëve. Çështje tjetër është mungesa e furnizimit të shkollave me lëndë djegëse.

Drejtori i DSHPE-s, z.Ramadush Osmani, Kompania Bechtel Enka, rrugën Bob – Doganaj kanë dashur ta bëjnë vetëm mbushje të gropave, mirëpo ne nuk i kemi lejuar.

z.Ibush Lika, Projekti i ujërave të zeza në f.Strazhë paska kaluar në kuadër të Ministrisë. Çfarë projekti ka komuna për f.Strazhë? Kush i menaxhon mbeturinat? Kërkojë praninë e inspektorëve në f.Strazhë, rrezikshmëria e fëmijëve është e lartë për shkak të shpejtësisë së veturave.

Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, F.Strazhë e kemi shpallur zonë turistike. Sa i përket mbeturinave kemi handikap, nuk kemi mjete për bartjen e mbeturinave.

z.Bekim Koxha, Të gjithë kanë kërkesë për ujë. Kemi ujë të mjaftueshëm , mirëpo mungon menaxhimi i ujit. Rruga e f.Koxhaj është në gjendje të mjerueshme. Nuk kemi trotuar, shtaza dhe ndriçim publik.

Kryesuesi i Kuvendit,z.Kemajl Mërseli, Faktori natyror ndikon në mungesën e ujit të pijes, nga temperaturat e larta. Ju falënderoj për pjesëmarrjen në takim të gjithë pjesëmarrësve.

Procesmbajtëse
Arbnora Kuka














Kryesuesi i Kuvendit
Kemajl Mërseli



Lista e pjesëmarrësve në debatin publik

10.09.2019

Tema: Korniza afatmesme buxhetore për Komunën e Kaçanikut për vitin fiskal 2020 dhe vlerësimet për vitet 2021-2022

Emri dhe Mbiemri	Pozita	Nr.i Telefonit	Nënshkrimi
1. ELDEM KYÇYKU - LVV -		045-366-575	
2. Selim Reka - LDK (Asamble.)		044172937	
3. EMRUSH LIKA - Përfagës, Fsh. Shtrazë		044 225 217	Elmush
4. NASER MURSELI Administrator Dëgjues		044-227-905	
5. Ibrahim Dalkoshi Administrator. Soponice		044121105	
6. Remzi Reka Gjethli		045 537 873	
7. Fotos Uishi DAK		044 253 011	
8. Elmihane Krasniqi/HANDIKOS/		044-235717	
9. ISUF TRENA /HANDIKOS/		044-491-870	
10. Fatmir Qaka (DAK)		044-346-157	
11. ISMAIL MURSELI (DAK)		045-217-411	
12. SHKODRAN ELEZI (ADMINISTRATOR)		049 490 737	
13. Elmar HASAI ADMINISTRATOR		0441292333	
14. RONI GABARICA KOXHARJ		044 854 821	
15. Qedrim Vogliqi Administrator		044 543355	
16. MENTOR KYÇYKU ADMINISTRATOR ZONA II		044-227-857	
17. VALON TERZIU ADMINISTRATOR - ELEZAJ		044-602-075	
18. KJANI KYÇYKU SH.K.A (GRYKA E KAÇANIKUT)			
19. ZIBER LUMA ADMINISTRATOR Fsh. Gllboçicë		044.9307	

20. ERBLINA ASANI KVRL 043909093 *[Signature]*
21. Ardiana Tuska KVRL 043982837 *[Signature]*
22. Aziz Koxhi KF "Lepenei" 044 712-782 *[Signature]*
23. Harip Jatihu ADMINISTRATOR 044 243659 *[Signature]*
24. FADIL USHI ADMINISTRATOR 044-225089 *[Signature]*
25. KJANI SALLAHU KF-BIGEC 044 164 710 *[Signature]*
26. PRANVERE LOKU-ZHARKU K.KOMUNALE 045 465 778 *[Signature]*
27. Lirije Luta - Ametane e Kuvendit 044-824-768- *[Signature]*
28. Nexhat Koleri - 16 044-235-761- *[Signature]*
29. _____
30. _____
31. _____
32. _____
33. _____
34. _____
35. _____
36. _____
37. _____
38. _____
39. _____
40. _____